

V E N D I M
Nr.453, datë 21.8.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.291, DATË
21.6.1994 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË APARTAMENTEVE QË NDËRTOHEN ME
FONDE SHTETËRORE”**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.291, datë 21.6.1994 “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, pika 7 ndryshohet si vijon:

“Për të gjitha rastet e parashikuara në këtë vendim, Enti Kombëtar i Banesave aplikon një shumë prej 4 për qind të vlerës së apartamentit për shpenzime operacionale, vleftë e cila do të arkëtohet menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi